

VENDIM
Nr. 555, datë 3.8.2005

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.30, DATË 28.1.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR KRITERET E ZGJEDHJES DHE RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË SHOQËRIVE, QË
DO TË NDËRTOJNË DHE PËRDORIN INSTALIME BREGDETARE PËR TRANSPORTIMIN DHE
DEPOZITIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “c” të pikës 7 të vendimit nr.30, datë 28.1.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë vijon:

“Ky afat, në çdo rast, nuk mund të jetë më shumë se 2 (dy) vjet.”.

2. Shoqërive, të cilave u ka skaduar afati i autorizimit të dhënë për vënien në dispozicion të sipërfaqes për ndërtimin e depozitave e të instalimeve bregdetare dhe që kanë nisur procedurat për marrjen e lejes së koncesionit, kanë të drejtën e aplikimit për t’u pajisur me këtë autorizim.

3. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano